



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.405/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi kryesues, Kujtim Pasuli dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Koalicionit AAK-NISMA, Konservatorët, Intelektualët me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 09.02.2025, merr këtë:

VE N D I M

I. Refuzohen të pabazuara ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.405/2025 dhe 406/2025, të datës 06.02.2025.

Paraqitur kundër Koalicionit AAK-NISMA, Konservatorët, Intelektualët me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datën 06.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesat e identifikuara me numër Anr.405/2025, dhe Anr.406/2025, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Koalicionit AAK-NISMA, Konservatorët, Intelektualët.

-Në ankesën Anr.405/2025, pretendohet se me 4 Shkurt 2025, kandidati për deputet i Koalicionit AAK-NISMA, Konservatorët, Intelektualët, z.Nexhmedin Sejdiu në tubimin elektorale të mbajtur me qytetarë në Prishtinë ndër të tjera ka deklaruar:

"Ka një tendencë edhe ka pasur në vazhdimësi që katër vite ta kap Gjyqësorin ta kap Prokurorinë" duke iu referuar Kryeministrit të Kosovës z.Albin Kurti.

-Ndërsa në ankesën Anr.406/2025 pretendohet se më datë 6 Shkurt 2025, kandidati për deputet i Koalicionit AAK-NISMA, Konservatorët, Intelektualët, z.Haki Abazi në tubimin elektorale të mbajtur me qytetarë në Prishtinë ndër të tjera ka deklaruar:

"Kurti po don me kthy 44-45 tën kur është ndjek e djathta shqiptare për me lëshu këtë vend, ai po don me taku shqiptarin në Gjermani e në Turqi, jo në Kosovë".

Sipas parashtruesit të ankesave me këto veprime kandidatët e koalicionit AAK-Nisma, për Zgjedhjet Parlamentare të datës 09.02.2025 z.Nexhmedin Sejdiu dhe z.Haki Abazi ka shkelur dispozitat e nenit 34 pika 1.11 e LZP-së, duke përhapur gjuhë të urrejtjes dhe shpifjes që do të mund të nxiste sulm ndaj të tjerëve .

Duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, kërkojnë nga PZAP-i që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ankesave si Provë kanë bashkangjitur CD – të deklarimeve të lartcekur.

Në përgjigjen në ankesa të subjektit politik Koalicioni AAK-NISMA, Konservatorët, Intelektualët theksohet si në vijim: Ankesën A.nr.405/2025 dhe Anr. 406/2025 dhe në afatin e përcaktuar ligjor jep këto përgjigje:

Në përgjigjet e Koalicioni AAK-NISMA, Konservatorët, Intelektualët lidhur me pretendimet në ankesa theksojnë: Lidhur me pretendimet në ankesën Anr.405/2025 theksohet se në asnjë moment nuk është përdorur emri i z.Albin Kurti në këtë deklaratë, për më tepër pretendimi që z.Sejdiu iu është referuar z.Kurtit nuk mbështet në asnjë provë por vetëm në deklaratën e subjektit ankues në ankesën e saj. Në vazhdim theksojnë se një deklaram i tillë është puro propagandë zgjedhore dhe nuk është përdorur asnjë gjuhë e urrejtjes dhe për me tepër "shpifja" nuk sanksionohet me dispozitat e Nenit 34, par. 1, nënpar. 1.11 të LZP-së.

Lidhur me pretendimet në ankesën Anr.406/2025 theksohet se nga deklarimi i lartcekur i z. Abazi gjatë takimit të tij në Prishtinë, në asnjë moment nuk ka përdorur gjuhë e cila ndalohe apo sanksionohet me dispozitat e Nenit 34 të LZP-së, dhe në asnjë moment përmes këtyre deklarimeve nuk nxitet dhunë apo fyerje ndaj të tjerëve. Më tutje theksojnë se duke u bazuar nga deklarimi i mësipërm të kandidatit në fjalë dhe nga dispozitat lartcekura mund të përfundojmë se i gjithë deklarimi nga z. Abazit ka qenë brenda kufijve të lirisë së shprehjes dhe për më tepër brenda kuadrit të një propagande zgjedhore e cila është një nga parimet themelore dhe demokratike të fushatës zgjedhore e përcaktuar me dispozitat e Nenit 4, par1, nënpar.1.5 të LZP-së.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si ne vijim: Anr.405/2025 dhe Anr.406/2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.405/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti i njëjtë politik LVV kundër subjektit të njëjtë politik Koalicionit AAK-NISMA, Konservatorët, Intelektualët, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesat gjeti se:

-Ankesat janë të pabazuara.

Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës të ofruara si provë materiale, ka gjetur se kandidatët e Koalicionit AAK-NISMA, Konservatorët, Intelektualët, dhe atë: z.Nexhmedin Spahiu kandidati për deputet nga radhët e këtij koalicioni ka deklaruar se: *“Ka një tendencë edhe ka pasur në vazhdimësi që katër vite ta kap Gjyqësorin ta kap Prokurorinë”* dhe kandidati për deputet nga radhët e këtij koalicioni, z.Haki Abazi, ka deklaruar: *“Kurti po don me kthy 44-45 tën kur është ndjek e djathta shqiptare për me lëshu këtë vend, ai po don me taku shqiptarin në Gjermani e në Turqi, jo në Kosovë”*. Paneli vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me gjuhë denigruese dhe urrejtëse në raport me subjektet politike që marrin pjesë në garën zgjedhore. Diskursi i tillë i përdorur nga kandidatet për deputet nga radhët e këtij subjekti politik z. Nexhmedin Spahiu dhe z. Haki Abazi dhe nuk mund të konsiderohet se përdorimi i një gjuhe të tillë mund të nxit ose provokon, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, po ashtu nuk është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se: *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërs si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.

Andaj Paneli, bazuar në provat e ofruara ka ardhur në përfundim se gjatë mbajtjes së fushatës zgjedhore të mbajtur me datë 04.02.2025 në Komunën e Prishtinës, kandidatët për deputet nga radhët e Koalicionit AAK-NISMA, Konservatorët, Intelektualë, ka vlerësuar se përdorimi i një gjuhe të tillë nuk bie në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP- së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.405/2025 më datën 09.02.2025

Kryesues i Panelit
Ramush Bardhi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.